

Stimulimi i gjuhëve – çfarë mund të bëjnë prindërit?

Ju si prindër vendosni, se me cilët gjuhë do t'i rrisni fëmijët tuaj. Ekzistojnë disa modele, që çojnë në shumëgjuhësi. Secila fëmijë e ka të drejtën të ketë gjuhën e nënës apo një gjuhë të parë. Fëmija juaj do të duhet të ketë mundësinë për të mësuar gjuhën e nënës (apo gjuhët e nënës).

Fëmija duhet të ketë mundësinë për shembull të flasë me gjyshërit dhe me të afërmit e vet, duhet të njohë prejardhjen e vet, gjuhën dhe kulturën si dhe duhet të ketë mundësinë që të komunikojë në këtë vend. Gjermanishtja si gjuhë e ambientit dhe e shkollës është një gjuhë e rëndësishme, të cilën gjuhë fëmija juaj duhet ta mësojë, në mënyrë që të mund të lidhë kontakte si dhe të ketë mundësi të mira për të mbaruar një kualifikim të mirë profesional. Ju mund të stimuloni fëmijën tuaj në një apo në disa gjuhë, po qe se kaloni kohë me të dhe duke folur shpesh me fëmijën tuaj. Këtë detyrë nuk e merr dot përsipër kompjuteri e as televizori!

Në qoftë se mund t'i përgjigjeni shumicës së pyetjeve të poshtë shënuara me „po“, atëherë jeni në rrugën e drejtë.

- A keni për çdo ditë pak kohë për fëmijën tuaj?
- A luani ndonjëherë me fëmijën tuaj?
- A vini re se si po zhvillohet fëmija? A vëreni, kur fëmija për shembull ka dhimbje veshi? Kur fëmija nuk dëgjon mirë?
- A flisni me fëmijën në lidhje me atë se çfarë ka bërë apo se çfarë ka përjetuar?
- A e lejoni fëmijën tuaj që të luajë në kopsht apo në parkun e lojërave dhe a i jepni hapësirë për të bërë lëvizje, për shembull duke luajtur në katrorin e rërës apo duke mbledhur gurë në plazh, duke u pllaquritur në ujë, duke luajtur në borë...?
- A gatvani apo përgatisni ndonjëherë ëmbëlçira bashkë me fëmijën tuaj?
- A e lejoni fëmijën tuaj të lozë së bashku me fëmijë të tjerë (gjithashtu edhe me fëmijë gjermanishtfolës)? A ka fëmija juaj shoqe dhe shokë?
- A flisni me fëmijën tuaj rreth ndonjë programi televiziv, që ka parë?
- A e dëgjoni fëmijën tuaj, kur ka dëshirë të ju rrëfejë diçka?
- A i rrëfeni fëmijës tuaj tregime (për shembull nga fëmijëria juaj, nga përditshmëria juaj..)?
- A shikoni bashkërisht libra fëmijësh me ilustrime?
- A i lexoni ndonjëherë përralla fëmijësh?

- A zotëroni ende këngë, vjersha, lojëra nga fëmijëria juaj në gjuhën tuaj të nënës?
- A i mëson fëmija këto prej jush?
- A shkoni bashkë me fëmijën tuaj në bibliotekën komunale dhe a huazoni atje libra apo kasete?
- A lexon fëmija juaj (nëse tashmë ka filluar të vijojë mësimin në shkollë) edhe në shtëpi?

© okay.zusammen leben/ *Projektstelle für Zuwanderung und Integration*

© okay.jetë e përbashkët/ *Zyra projektuese për migrim und integrim*